

20200180330

LIGJ PËR ASISTENCËN E TË RINJVE

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen realizimi i të drejtës së asistencës së të rinjve, procedura, kushtet dhe lartësia për pagesën e asistencës së të rinjve personit të ri në moshë deri në 23 vjet.

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është nxitja e personave të rinj që të përfshihen në tregun e punës në veprimtarinë e prodhimit, ndërsa nëpërmjet përkrahjes financiare të sigurohet punësimi në periudhë më të gjatë kohore dhe përmirësimi i pozitës së tyre ekonomike.

Neni 3

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1) **"Person i ri"** në kuptim të këtij ligji është personi fizik në moshë deri në 23 vjet me minimum arsim të mesëm të përfunduar i cili në bazë të punësimit dhe vetëpunësimit në veprimtarinë e prodhimit është i përfshirë me sigurim të detyrueshëm social në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me Ligjin për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social, si dhe personi fizik në moshë deri 23 vjet me minimum arsim të mesëm të përfunduar, të cilit veprimtaria bujqësore i është profesion i vetëm dhe i cili realizon të hyra në bazë të ushtrimit të veprimtarisë bujqësore dhe është obligues për llogaritje dhe pagesë të kontributit/eve nga sigurimi i detyrueshëm social, në pajtim me Ligjin për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social;

2) **"Asistencë e të rinjve"** është asistencë mujore e cila paguhet nga Buxheti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) në llogari të transaksionit të personit të ri;

3) **"Veprimtari kryesore prodhuese"** në kuptim të këtij ligji është veprimtaria e punëdhënësit nga klasat e lidhura me prodhimtari në pajtim me Klasifikimin nacional të veprimtarive Rev.2.

Neni 4

Asistencë të të rinjve mund të shfrytëzojë personi i ri i cili i plotëson këto kushte:

- është i përfshirë me sigurim të detyrueshëm social në bazë të punësimit te punëdhënësi ose vetëpunësimit me veprimtari kryesore prodhuese,
- është i punësuar në agjenci private për punësim dhe ka kaluar në punë te punëdhënësi me veprimtari kryesore prodhuese ose
- është i përfshirë në sigurimin e detyrueshëm social si bujk individual.

Neni 5

Asistenca e të rinjve paguhet nëse personit të ri i është paguar rrogë dhe kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social nga punëdhënësi, përkatësisht personi i vetëpunësuar në procedurë dhe në afat të përcaktuar me ligj, përveç për bujkun individual për të cilin asistenca paguhet pas pagesës së kryer të kontributit/eve nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me ligjin në bazë të të dhënave të siguruar nga Drejtoria e të Hyrave Publike.

Neni 6

Listën me klasat në të cilat janë përmbajtur veprimtaritë prodhuese nga Klasifikimi nacional i veprimtarive Rev.2, e përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

Neni 7

(1) Asistenca e të rinjve është 3.000 denarë për kohë të plotë të punës, në të cilën paguhet tatim mbi të ardhura personale dhe paguhet një herë në muaj në llogari të transaksionit të personit të ri më së voni deri më 25-tin e muajit për muajin/të paraprak/ë.

(2) Të drejtën e asistencës së të rinjve personi i ri e realizon pas kërkesës së parashtruar në Qendrën kompetente për punësim, sipas vendit të jetesës të personit të ri, nëse personi i ri i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

(3) Agjencia në procedurën pas kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni me detyrë zyrtare siguron të dhëna për plotësimin e kushteve nga neni 4 i këtij ligji, në bazë të evidencës së fletëparaqitjeve të regjistruara në sigurimin e detyrueshëm social të cilën Agjencia e mban në pajtim me ligjin.

(4) Të dhënat për plotësimin e kushteve nga neni 5 i këtij ligji për rrogë të paguar personit të ri nga punëdhënësi, Agjencia i siguron me detyrë zyrtare nga Drejtoria për të Hyra Publike.

(5) Agjencia, të dhënat për veprimtari kryesore prodhuese i siguron me detyrë zyrtare nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të shifrës së evidentuar të të hyrave (kryesore).

(6) Agjencia të dhënat për personat e përfshirë në sigurimin e detyrueshëm social si bujq individualë, i siguron me detyrë zyrtare nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut dhe/ose Fondi për Sigurim Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(7) Agjencia të dhënat nga paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij neni i siguron përmbledhtas për të gjitha kërkesat e parashtruara një herë në muaj, para afatit të përcaktuar për pagesë në paragrafin (1) të këtij neni.

(8) Asistenca e një rinjve nga paragrafi (1) i këtij neni, paguhet deri në ndërprerjen e sigurimit të detyrueshëm social në bazë të punësimit ose vetëpunësimit, përkatësisht ndërprerjen e sigurimit të detyrueshëm social si bujq individual, e më së shumti deri në mbushjen e 23 viteve të personit të ri.

(9) Agjencia kryen kontrollin e plotësimit të kushteve për pagesë me detyrë zyrtare, nëpërmjet sigurimit të të dhënave nga paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij neni.

(10) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, i përcakton ministri kompetent për çështje nga sfera e punës në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Neni 8

(1) Pas kërkesës nga neni 7 paragrafi (2) të këtij neni, Qendra kompetente për punësim miraton aktvendim në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(2) Për aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Neni 9

Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji kryen Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Neni 10

(1) Akti nënligjor miratimi i të cilit është përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Lista nga neni 6 i këtij ligji, do të përcaktohet në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", ndërsa do të zbatohet nga 1 dhjetori 2019 deri më 30 nëntor 2022.